REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 01/02 — Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 2522-1/2025
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 2 — Data / Datum / Date: 28, 02, 2025
Hyrëse — PRISHTINË/A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarsvo za Finansije, Rada i Transfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers*

---

Nr. 60/1/2025
Datë:

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe bazuar në nenet 29 dhe 30 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe në pajtim me nenin 7 paragrafi 7 nën-paragrafi 7.1 të Rregullores QRK) Nr. 12/2023 Mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, Njësia Përgjegjës për Monitorimin dhe Mbikëqyrjen e Punës të Agjencive Ekzekutive në MFPT nxjerr këtë:

# VENDIM

1. Miratohet Plani Vjetor i Performancës për vitin 2025 për Inspektoratin e Punës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Njësia Përgjegjës**

**Agon Dobruna, Zv/Minister në MFPT, Kryesues**

**Ylber Aliu, Udhëheqës i Divizionit të Politikave të Punësimit, Anëtar**

**Xhevat Simnica, Menaxher i Prokutimit, Anëtar**

Vendimi i dërgohet:

- Kabineti Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Njësia Përgjegjëse e Agjencive Ekzekutive të MFPT-së.
- Arkivit të MFPT-së.

**Pjesa përshkruese e Planit të Performancës së Inspektoratit Qëndror të Punës**

Përmbledhje Ekzekutive

Me qëllim të përmbushjes së misionit të tij, Inspektoratit Qëndror të Punës synonë të realizojë objektivat e parapara në kuadër të Planit të Performancës për vitin 2025.

**1. Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit dhe akteve nënligjore që rregullojnë marrdhënjen e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë.**
**2. Implementimi i Sistemit Informativ të Inspektoratit Qendror të Punës(SHQP).**
**3. Imlementimi i struktures organizative dhe ngritja e kapaciteteve në Inspektoratit Qëndror të Punës**
**4.Ngritja e transparences dhe mardhenia me publikun**

Inspektorati Qendror i Punës për vitin 2025 ka të punësuar gjithsejtë 86 të punësuar si dhe buxhetin e përgjithshëm prej 1.518,440.81 Euro, me synimin që numri i të punësuarëve të shtohet edhe për 60 Inspektor të Punës si dhe 25 pozita në administratë me qka Inspektorati punës synon që të kompletohet me staf për të kryer të gjitha funksionet si Agjenci Ekzekutive brenda fushëveprimtaris së tij.
Përveç buxhetit të lejuar për vitin 2025, Inspektorati Qendror i Punës synon të zhvillojë aktivitete të atilla të cilat do të mundësonin marrjen e përkrahjes nga donatorët, ndihmë e cila do të konsistonte në ofrimin e ndihmës për trajnimet specifike të planifikuara në planin për trajnim të stafit për vitin 2025, për të cilat kërkohet ekpert nga jashtë si dhe marrja e ndihmës dhe përkrahjes nga fusha e TI-së.

2. Hyrje

Plani i Performancës për vitin 2025, është përgatitur bazuar në nevojën për fuqizim më të madh të rolit të Inspektoratit Qendror të Punës, dhe në zbatim të fushëveprimtarisë dhe mandatit ligjor të institucionit.
Inspektorati Qendror i Punës është institucion shtetëror i pavarur, i themeluar në bazë të Ligjit Nr.200/9 Për Inspektoratin e Punës dhe Ligji Nr. 03/L-017 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9 është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit nga fushat e marrëdhënis së punës, siguria dhe shëndeti në punë si dhe të ligjeve të tjera të cilat i mbikqyr sipas përcaktimit në ligjet respektive .

Objektivat e përcaktuar për vitin 2025, ofrojnë mundësi për fuqizimin e IQP-së në përputhje të mandatit të dhënë ligjor dhe përgjegjësive kryesore që i janë përcaktuar në raport me mbikëqyrjen e fushave që ka autorizimit ligjor duke ndikuar në rritjen e cilësisë e clia do ndikojë edhe në rritjen e besueshmërisë në këtë Institucion.
Objektivat për vitin 2025, të cilat planifikohen të realizohen janë objektiva gjithëpërfshirëse, po aq edhe specifike me nevojat dhe gjendjen në IQP-së,
Për realizimin e këtyre objektivave në kuadër të planit janë përcaktuar afatet, aktivitetet dhe njësitë apo personat përgjegjës për realizimin e këti plani.
Për hartimin e këtij dokumenti, IP ka zhvilluar konsultime brenda IP me të gjitha njësitë përgjegjëse, duke analizuar edhe performancën aktuale në raport me fushëveprimin e tij.
Po ashtu përgjatë hartimit të këtij dokumenti është marr për bazë gjendja faktike nga të dhënat që posedon IQP me qëllim që në këtë plan të përfshihen të gjitha nevojat dhe të adresohen për zgjidhje të gjitha qështjet të cilat secila nga këndi vetë ka paraqitur pengësën

në punën e IP-së, dhe po ashtu gjatë hartimit të këtij plani janë marr për bazë të gjitha sfidat dhe rreziqet që mund të paraqiten gjatë zbatimit të këtij plani.
Për realizimin e objektivave, përveq bazimit në buxhetin vetanak është përfshirë apo paraparë edhe ndihma që ofrohet nga IKAP në fushën e trajnimeve, ndihma nga institucione tjera publike si dhe me theks të veqant, target do të jenë gjetja e donatorëve.
Sfidat kryesore të identifikuara që mund të paraqiten në realizimin e Planit të Performancës janë kryesisht në mungesën e mundshme të buxhetit, e që ndërlidhet me sigurimin e hapsirave të mjaftueshme të punës, mejtet e punës: si vetura të tjera dhe kalimi nga inspektimi manual në E-inspektimi.
Po ashtu si sfidë tjetër është procedura e rekrutimit të 60 inspektorëve të rinjë të planifikuar të angazhohen në vitin 2024 dhe stafin tjetër mbështetës ne funksionalizimin e sektorëve të cilët janë parapar me Rregulloren (ZKM)Nr.10/2024 Për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Ekzekutive të Inspektoratit Qendror të Punës.

Përmbledhje e Objektivave

Objektivat e përcaktuara në përmbledhjen ekzekutive, përfshijnë aktivitetet konkrete për vitin 2025. Në kuadër të kësaj, IQP do të përgadisë sipas nevojës edhe Plane të veprimit, të cilat do të ndihmonin arritjen e objektivave në vijim:

**Objektivi 1: Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit dhe akteve nënligjore që rregullojnë marrdhënjen e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë.**

Në këtë objektivë synohet realizimi sa më efikas i mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit që bie ne mandatin e Inspektoratit Qëndror të Punës, të cilat ndikojn ne promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punësuarve.

Aktivitetet të cilat do të realizohen për realizimin e këtij objektivi janë:

- Hartimi i planit vjetor të inspektimeve; Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, DCI-së dhe DKR-të. (K1)
- Inspektime të planifikuara, të paplanifikuara, sipas parashtresës, riinspektime, inspektime të përbashkëta; - DKR-të (K1-K4)
- Luftimi i informalitetit me 1100 inspektime të dedikuara vetëm për punën e padeklaruar veqanrisht në sektorin e ndërtimtarisë dhe gastronomisë – DKR-të (K2, K3. K4).
- Inspektime specifike nga siguria dhe shëndeti në punë në 350 subjekte në veprimtarit me rrezikshmëri të lartë me qëllim te parandalimit te aksidenteve ne vendin e punës - DKR-të K1-K4)
- Nxjerrja e raportit nga gjitha inspektimet e kryera nga I cili identifikohen subjektet me rsik te lartë DCI-së(K-4)

- Norma e numrit të inspektimeve në 30 inspektime në muaj, sipas parimit të inspektimeve në qift. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, DCI, DKR, Inspektorët e punës (K1, K2, K3, K4)
- Trajnimi i vazhdueshëm i inspektorëve të punës dhe stafit mbështetës administrativ. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, DCI, NBNJ (K2, K3, K4)

- Realizimi i inspektimeve cilësore për mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin,Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara; Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, DCI, DKR (K1, K2, K3, K4).
- Realizimi i inspektimeve cilësore për mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr.05/L -023 për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri; Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, DCI, DKR (K1, K2, K3, K4).
- Realizimi i inspektimeve cilësore për mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr.06/L-085 Për mbrojtjen e Sinjalizuesve; Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, DCI, DKR (K1, K2, K3, K4).
- Realizimi i inspektimeve cilësore për mbikqyrjen e punës së të punësuarve të mitur. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, DCI, DKR (K1, K2, K3, K4).
- Monitorimi i inspektimeve – DCI (K1-K4).

**Objektivi 2: Implementimi i Sistemit Informativ të Inspektoratit Qendror të Punës(SHQP).**

Në këtë objektivë synohet përmirësimi i procesit të Inspektimit dhe transormimi nga sistemi manual i inspektimit në inspektime permes sistemit të inspektimeve E-Inspektim.

Aktivitete që synohen të realizohen për arritjen e këtij objektivi:

- Implementimi i plotë i SHQP-së – (K1-K4) Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, DKR
- Gjenerimi i raporteve dhe statistikave(K1-K4) DCI.DKR;
- Inspektimet e bazuara në riskë (K1-K4) Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, DCI, DKR;

**Objektivi 3. Imlementimi i struktures organizative dhe ngritja e kapaciteteve në Inspektoratit Qëndror të Punës**

Me këtë objektiv synohet funksionaliteti me synim rritjen e efikasitetit, llogaridhënjes në realizimin e mandatit ligjor të IQP-së

Aktivitetet që synohet të realizohen në kuadër të kësaj objektive:

- Ristrukturimi i IQP-së sipas Rregullorës (ZKM)Nr.10/2024 Për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në IQP – Zyra e Drejtorit Ekzekutiv (K-1)
- Rekrutimi i Stafit sipas Rregullorës (ZKM)Nr.10/2024 Për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në IQP –Zyra e Drejtorit Ekzekutiv dhe NJBNJ (K1-K4)
- Plani i trajnimeve për stafin e IQP-së– Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, DCI, NJBNJ (K2-K3-K4)
- Implementimi i Sistemit SMAED (E- arkiva) DASHP-(K1-K2-K3-K4)

**Objektivi 4. Ngritja e transparences dhe mardhenia me publikun.**

Per të jetësuar parimin për administratë të hapur dhe transparente dhe për të ndërtuar një marrdhënie të shëndoshë dhe profesionale me publikun është parapar në objektivin synon të ngrisë transparenën dhe të rregullojë marrdhënien me publikun duke siguruar transparencë dhe ofrim të informimit të saktë dhe në kohë reale.

Aktivitetet që synohet të realizohen në kuadër të kësaj objektive:

- Bashkëpunimi i rregulltë me mediat dhe palët e interesuara lidhur me aktivitetet e IQP-së. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv (K1, K2, K3, K4)
- Publikimi i kontratave të nënshkruara sipas LPP-së -DASHP, Divizioni I Prokurimit (K1, K2, K3, K4)
- Organizimi i fushatave vetëdijësuese dhe mbajtja e takimeve me perfaqsuesit e punëdhënësve dhe punëmarrësve të sektorëve të ndryshëm. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, DCI.K1-K2)
- Përditësimi i rregullt i webfaqes së IQP-së. DASHP (K1, K2, K3, K4)

| Data: | 07.11.2024 |
| --- | --- |
| Agjencia | Inspektorati Qendrori i Punës |
| Ministria Përgjegjëse | Ministria e Finacave Punës dhe Transfereve |
| Misioni i Agjencisë | Inspektorati i Punës është organ i pavarur i Administratës Shtetërore i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. IP është i vetmi organ në kuadër të pushtetit ekzekutiv të Republikës së Kosovës i cili bënë monitorimin e zbatimit të legjislacionit nga fusha e marrëdhënies së punës si dhe sigurisë dhe shëndetit në punë. Baza ligjore për themelimin dhe funksionimin e IP është përcaktuar me Ligjin nr. 2002/9 mbi Inspektoratin e Punës në Kosovë, Ligjit Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës 2002/9 si edhe me Rregulloren Nr.10/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në IQP. |
| | |

| Objektivat | Treguesi(t) | Vlera bazë | Vlera e synuar | Rezultatet (Autputet) | Alokimi financiar | Referenca ndaj dokumenteve strategjike/politike |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Mbikëqyrja e zbatimit të Legjislacionit dhe akteve tjera nënligjore që rregullojnë marrdhënjën e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë. | 1.Rritja e numrit të inspektimeve | 10,000 numri i inspektimeve | 11,0000 inspektime | Sigurimi i zbatimit të ligjeve dhe akteve nenligjore që mbikqyrë Inspektorati Qendror i Punës | 81,838.00 | Plani zhvillimor i Inspektorait Qendror të Punës 2023-2027. Plani vjetor i punës 2025. |
| | 2.Puna e padeklaruar (Informaliteti) | 10,000 numri i inspektimeve që përfshin edhe informalitetin. | 1000 inspektimi nga numri i përgjithshëm i inspektimeve 11,0000 të synuara. | Luftimi i informalitetit | 60,000.00 | |
| 2. Implementimi i Sistemit Informativ të Inspektoratit Qëndror të Punës (SIIQP). | 1.Rritja e efikasitetit dhe cilësis së inspektimeve. | 70% | 100% | Implementimi i plotë i SIIQP-së. | 100.000 $ USD | Plani zhvillimor i Inspektorait Qendror të Punës 2023-2027. |
| | 2.Gjenerimi i raporteve dhe statistikave. | 50% | 100% | Inspektimet e bazuara në risk. | 100.000 $ USD | |
| | 3. Identifikimi i subjekteve të me rrezik të lartë. | 30% | 70% | Inspektimet e bazuara në risk. | 100.000 $ USD | |
| 3.Implementimi i strukturës organizative dhe ngritja e kapacitetve ne Inspektoratit Qëndror të Punës. | 1. Implementimi i sistematizimit të vendeve të punës sipas Rregullores së IQP Nr. 10/2024 | 60% | 100% | Ristrukturimi i IQP-së | N/A | Plani zhvillimor i Inspektorait Qendror të Punës 2023-2027. |
| | 2.Plani i trajnimeve të stafit për vitin 2025. | 60 | 171 | Staf i trajnuar | 25,000.00€ | Rregullorja e IQP Nr. 10/202 |
| | 3.Rritja e numrit të Inspektorve të Punës. | 62 | 60 | 122 | 561,990.0€ | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 4.Rritja e numrit të stafit mbështetës administrative. | 24 | 49 | | 10,000.00€ | |
| | 5. Implementimi i Sitetmit SMAED (E-arkiva) | 30% | 100% | | Minisrie a Punëve të Brendshme (ASHI) | |
| | 6.Vazhdimi i përmirsimit të kushtëve të punës të IQP-së (Veturat zyrtare) | 5 | 6 | Ngritja e kapaciteteve të punës | 105,000.00€ | |
| 4. Ngritja e transparencës dhe marrëdhënia me publikun. | 1.Vazhdimi i bashkëpunimit të rregullt me mediat dhe palët e interesuara lidhur me aktivitetet e IQP-së. | 100% | 100% | Sigurimi i qasjes në dokumente të IQP-së. | 9,000.81€ | Plani zhvillimor i Inspektorati Qendror të Punë 2023-2027. |
| | 2.Vazhdimi i publikimit të të gjitha kontratave të nënshkruara sipas LPP-së. | 0% | 100% | Publikimi në web-faqe i kontratave të nëshkruara. | N/A | |
| | 4.Informimi i publikut me shpenzimet e IQP-së. | 0% | 100% | Llogaridhënja | N/A | |
| | 5.Vazhdimi i organizimit të fushatave vetëdijësuese dhe mbajtja e takimeve me perfaqesuesit e punedhenesve dhe punëmarrësve te sektoreve te ndryshem | 100% | 100% | Ngritja e vetëdijëzimit me të drejtat e punëtorëve dhe ngritja e bashkëpunimit me akterët kyç. | Donatorët | |

Drejtori Ekzekutiv i
Inspektorati Qëndror i Punës

Z. Hekuran Nikçi

________________

Njësia Përgjegjëse

________________